

LIGJ
Nr.7653, datë 23.12.1992

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR, 7512, DATË 10.8.1991 "PËR SANKSIONIMIN DHE
MBROJTJEN E PRONËS PRIVATE, TË NISMËS SË LIRË, TË VEPRIMTARIVE PRIVATE
TË PAVARURA DHE PRIVATIZIMIT"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Paragrafi i dytë i nenit 21 ndryshohet si vijon:

"Personave fizikë a juridikë të huaj u jepet truall për ndërtim nga persona fizikë a juridikë vendas me qira për një periudhë deri në 99 vjet, sipas një kontrate të veçantë. Në raste të veçanta, për investime të rëndësishme, trualli mund t'u shitet të huajve me miratim të Kuvendit Popullor".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.410, datë 4.1.1993, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.